



**BASHKIA KORÇË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Korçë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

## **RELACION**

### **Për**

### **përcaktimin e ndihmës financiare për Zotin Tomi Sofroni, të ciliti është dëmtuar banesa nga rënia e zjarrit.**

Në datën, 22.09.2023, në banesën e qytetarit Tomi Sofroni, me adresë, Lagjia 12, Rruga “Kongresi I Lushnjes”, Banesa Nr. 63, Rajoni nr. 1, Korçë, ka rënë zjarr, i cili shkaktoi dëme të mëdha në orendi shtëpiake dhe nga ana ndërtimore.

Bazuar në nenin 41, të Ligjit, 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, dhe VKM-në, nr. 329, datë, 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, kapitulli i III-të, pika 1, gërma b, pasi u verifikua vërtetësia e fakteve të paraqitura në kërkesë, u dergua Komisioni i Konstatimit, i cili mbajti Procesverbalin e konstatimit të gjëndjes për dëmet e shkaktuara në vëndngjarje.

Procesverbali i hartuar nga Komisioni i Konstatimit sipas VKM-së, nr. 329, datë, 16.05.2012, ju dërgua Komisionit të ekspertëve në Këshillin e Qarkut Korçë, i cili bëri vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objekt.

Mbështetur në preventivat e kryer nga Komisioni i ekspertëve në Këshillin e Qarkut Korçë, për dëmet e shkaktuara, i propozohet Këshillit të Bashkisë, për dhënien e ndihmës financiare, për përballimin e disa shpenzimeve emergjente.

Bazuar në VKM-në, nr. 329/2012, si dhe preventivin e përgatitur nga ekspertët e Këshillit të Qarkut, dëmet e shkaktuara në orendi shtëpiake të llogariten në masën 100%, përkatësisht në masën **233,000**lek, kurse dëmet e llogaritura banesë, të llogariten në masën 50%, përkatësisht në masën **546,490.85** lek, dhe ndihma financiare mendojmë të jetë si më poshtë:

### **1- Ti jepet ndihmë financiare personit të lartpërmendur për dëmet në orendi shtëpiake dhe nga ana ndërtimore në shumën prej **779,490,85**lek.**

Kjo shumë do të përballohet nga fondi i planifikuar për Emergjencat Civile të miratuar në buxhetin e vitit 2023, sipas VKB-së, nr. 24, datë, 09.02.2023, “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2022 të Bashkisë, institucioneve të varësisë në Buxhetin e vitit 2023”, në programin e siguria publike me këtë strukturë buxhetore:

Prog. AB122 00 Prod. V091AAD01 Art. 6060000 **779,490,85** lek, (Siguria Publike)

Propozimi i mësipërm është bërë duke ju referuar nenit 30, të Ligjit nr. 45/2019, “Për Emergjencat Civile”, të nenit 29, të Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, VKM-së, nr. 329 datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, kreu i III<sup>ë</sup>, pika 2 gërma ë, Ligji nr. 9936, datë, 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në Ligjin nr. 84/2022, “Për buxhetin e shtetit për vitin 2023”, Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, VKB-në, nr.183, datë, 28.12.2022 “Për miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2023, dhe PBA të Bashkisë Korçë” dhe VKB-në, nr. 24, datë, 09.02.2023, “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2022 të bashkisë, institucioneve të varësisë në Buxhetin e vitit 2023” dhe urdhërit nr. 131 datë 13.2.2023 “Për detajimin e shpenzimeve korrente në buxhetin e vitit 2023 për Bashkinë dhe Institucionet e Varësisë”, sipas programeve dhe produkteve dhe sipas VKB nr. 24 datë 9.2.2023.

Përgj. Sek. të Em.Civile

Arjan Qasolli

Drejtoria e Përgjith. Financës, Buxhetit dhe M.F.K

Valbona Ziko

Drejtoria e Përgjith. Juridike

dhe Burimeve Njerëzore

Anxhela (Dishnica) Qeramixhi

**KRYETARI I BASHKISË**

**Sotiraq FILO**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

**PROJEKT VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë, \_\_\_\_\_ 2023

**MBI**

**MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ZOTIT TOMI SOFRONI, PËR DËMET E SHKAKTUARA NGA ZJARRI NË BANESËN E TIJ.**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, (Sektori i Emergjencave Civile), bazuar në Ligjin, 45/2019, "Për Mbrojtjen Civile", të nenit, 29, të Ligjit nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", VKM-së, nr. 329, datë, 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", kapitulli i III-të, pika 2, gërma ë, Ligjit, 9936, datë, 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar", në Ligjin, 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin nr. 84/2022, "Për buxhetin e shtetit për vitin 2023", Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018, i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, VKB-në, nr.183, datë, 28.12.2022 "Për miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2023, dhe PBA të Bashkisë Korçë" dhe VKB-në, nr. 24, datë, 09.02.2023, "Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2022 të bashkisë, institucioneve të varësisë në Buxhetin e vitit 2023", Këshilli i Bashkisë Korçë:

**VENDOSI**

1. Miratimin e ndihmës financiare Zotit **Tomi Sofroni**. për dëmet e shkaktuara, nga rënia e zjarrit në banesën e tij në shumën prej, **779,490,85 lek**.
2. Kjo shumë do të përballohet nga fondi i planifikuar për Emergjencat Civile të miratuar në buxhetin e vitit 2023, sipas VKB-së, nr. 24, datë, 09.02.2023, "Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2022 të bashkisë, institucioneve të varësisë në Buxhetin e vitit 2023" me këtë strukturë buxhetore:

Prog. AB122 00 Prod. V091AAD 01 Art. 6060000 **779,490,85** lek, (Siguria Publike)

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MKF, Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Emergjencave në Bashki.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**  
**Eva NAÇIKRYETAR**

Miratuar me \_\_\_\_\_ vota **Ana VERUSHI**

Vota pro \_\_\_\_\_



**BASHKIA KORÇË**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASHKISË**

**VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë, \_\_\_\_\_ 2023

**MBI**

**MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ZOTIT TOMI SOFRONI, PËR DËMET E SHKAKTUARA NGA ZJARRI NË BANESËN E TIJ.**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, (Sektori i Emergjencave Civile), bazuar në Ligjin, 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, të nenit, 29, të Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, VKM-së, nr. 329, datë, 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, kapitulli i III-të, pika 2, gërma ë, Ligjit, 9936, datë, 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, në Ligjin, 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin nr. 84/2022, “Për buxhetin e shtetit për vitin 2023”, Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018, i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, VKB-në, nr.183, datë, 28.12.2022 “Për miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2023, dhe PBA të Bashkisë Korçë” dhe VKB-në, nr. 24, datë, 09.02.2023, “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2022 të bashkisë, institucioneve të varësisë në Buxhetin e vitit 2023”, Këshilli i Bashkisë Korçë:

**VENDOSI**

1. Miratimin e ndihmës financiare Zotit **Tomi Sofroni**, për dëmet e shkaktuara, nga rënia e zjarrit në banesën e saj në shumën prej, **779,490,85 lek**.
2. Kjo shumë do të përballohet nga fondi i planifikuar për Emergjencat Civile të miratuar në buxhetin e vitit 2023, sipas VKB-së, nr. 24, datë, 09.02.2023, “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2022 të Bashkisë, institucioneve të varësisë në Buxhetin e vitit 2023” me këtë strukturë buxhetore:

Prog. AB122 00 Prod. V091AAD 01 Art. 6060000 **779,490,85 lek**, (Siguria Publike)

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MKF, Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Emergjencave në Bashki.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**  
**Eva NAÇIKRYETAR**

Miratuar me \_\_\_\_\_vota

**Ana**

**VERUSHI**

Vota pro \_\_\_\_\_

Vota kundër \_\_\_\_\_

Vota Absteni \_\_\_\_\_

Zbardhur më datë \_\_\_\_\_